



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 6 dhe 19.2 të Ligjit për transportin rrugor, nr.2004/1 dhe nenit 15.2 shkronja c të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 janar 2012, miratoi këtë:

VENDIM

PËR VËNIE NË DISKUTIM PUBLIK TË PROPOZIM VENDIMIT PËR CAKTIMIN E LINJAVE URBANE, URBANO – PERIFERIKE DHE ORARIN E QARKULLIMIT

Neni 1

Vihet në diskutim publik propozim :

- Vendimi për caktimin e rrjetit të linjave urbane, urbano – periferike dhe orarin e qarkullimit

Neni 2

Diskutimi publik zgjatë 30 ditë përkatësisht prej 31 janar 2012 deri më 1 mars 2012 dhe debati me qytetarë mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, më 23 shkurt 2012 në orën 11.00.

Neni 3

Vërejtjet, plotësimet dhe sugjerimet paraqiten ditën e mbajtjes të diskutimit publik , gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën e informimit, ndërtesa e Kuvendit zyra nr. 32.

Neni 4

Propozimi i vendimit , sipas nenit 1 të këtij vendimi, publikohet në Web faqen zyrtare të Komunës <http://kk.rks-gov.net/podujeve> ndërsa në formë të shkruar qytetarët, shoqatat joqeveritare, grupet e interesit dhe të gjithë të interesuarit të tjerë mund ta marrin në Zyrën e informimit e cila njëkohësisht është e obliguar të bëjë njoftimet e nevojshme përmes mjeteve të informimit.

Neni 5

Nën mbikëqyrjen e kryetarit të Komunës, diskutimin publik e zbaton Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit e cila njëkohësisht është e obliguar që për Kuvend të përgatitë raportin për zbatimin e diskutimit publik mbi bazën e propozimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve të dhëna në aktin e propozuar dhe të jap sqarime për arsyeshmërinë për pranimin apo mospranimin e propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Vendimi hynë në fuqi ditën e miratimit.

Nr. 01/19 - 346
Podujevë,
30 janar 2012

Kryesuesi i Kuvendit
Hazir Raçi